



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura e VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi

Mbledhja nr.15

Prishtinë, më 13.4.2018, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 10

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Teuta Haxhiu, Nezir Çoçaj, Abdyl Salihu, Adem Mikullovc, Arbërie Nagavci, Albulena Balaj – Halimaj, Verica Çeraniq dhe Fidan Rekalu.

Munguan: Ismajl Kurteshi, kryetar, Valentina Bunjaku – Rexhepi dhe Mufera Shinik.

Përfaqësues të tjerë: Ministri i Arsimit, Shyqiri Bytyçi.

Stafi mbështetës i komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi: Teuta Haxhiu, zëvendëskryesuesja e parë e komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky :

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. 9/39 të dt. 4.4.2018 për Ratifikimin e anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë të AKA.**

Zëvendëskryesuesja, Teuta Haxhiu, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. 9/39 të dt. 4.4.2018 për Ratifikimin e anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë të AKA

Teuta Haxhiu në fillim tha se është në interes të gjithëve që të formohet sa më parë bordi i Këshillit Shtetëror të Cilësisë, emrat e propozuar i kemi para vetes dhe do të bëjmë përpjekje që në mbledhjen e radhës të miratohet rekomandimi i komisionit, duke pasur parasysh se kjo agjenci është përgjegjëse për vlerësimin e cilësisë së arsimit të lartë në Kosovë. Tutje i dha fjalën Ministrit të Arsimit, Shyqiri Bytyçi.

Ministri i Arsimit tha se ministria ka hartuar një udhëzim administrativ, në hartimin e të cilit kanë marrë pjesë përfaqësues të Ministrisë, të Komisionit Parlamentar për Arsim, përfaqësues të ËUS Austria, përfaqësues të ASHAK-ut, përfaqësues të Rektoratit, si dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Pas hartimit të udhëzimit administrativ është formuar një komision nga 5 anëtarë dhe është bërë thirrje publike për aplikim për pozitën anëtarë të Këshillit Shtetëror të Cilësisë. Gjithsej kanë aplikuar 35 kandidatë, nga ata 16 janë futur në listë të ngushtë duke i plotësuar kushtet sipas udhëzimit administrativ, ku është bërë përzgjedhja e 9 anëtarëve, bazuar në kriteret e kërkuara dhe barazinë gjinore. Kjo listë përmban anëtarë profesionalë dhe kredibil.

Teuta Haxhiu në vijim kërkoi sqarim nga ministri lidhur me ankesën që iu është dërguar anëtarëve të komisionit nga kandidati Mentor Sopjani, i cili ka deklaruar që nuk është ftuar fare në fazën e intervistës.

Ministri i Arsimit sqaroi që Mentor Sopjani ka qenë i thirrur në intervistë dhe ka qenë në listë të ngushtë, mirëpo që i njëjti ka pasur poentim të njëjtë me Arta Jakupin, që i është dhënë përparësi duke e respektuar parimin e gjinisë femërore.

Arbërie Nagavci shtoi se tutje duhet të i kemi parasysh obligimet pas rekomandimit të Kuvendit që ka të bëjë me veprimet në raport me Këshillin Shtetëror të Cilësisë.

Nezir Çoçaj tha se afatet kohore janë shumë të shkurtra të listës me emrat e propozuar, por duke pasur parasysh rëndësinë e formimit të Këshillit, përkundër pakënaqësisë mbi përzgjedhjen e anëtarëve, pajtohëm me procedimin tutje të listës.

Teuta Haxhiu propozon që të fillojë procesi i votimit. Votimi ka qenë 7 për dhe 1 kundër (Verica Çeraniq)

Pas diskutimeve, Komisioni i paraqet Kuvendit këtë rekomandim:

- I.** Rekomandohet Kuvendit të Kosovës të bëjë ratifikimin e 9 (nëntë) anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë, me këtë përbërje:

1. Prof. Ass. Dr. Vjollca Krasniqi
2. Prof. Ass. Dr. Arta Jakupi

3. Dr.Sc.Spec. Rozafa Koliqi- Lila
4. Prof. Dr. Magdalena Ziolo
5. Prof. Dr. Gazmend Luboteni
6. Pror. Dr. Herbert K. Amato
7. Prof.. Dr. Xhavit Rexha
8. Prof. Msc. Jeffery Butel
9. Prof. Ass. Dr. Dukagjin Zeka

Mbledhja përfundoi në orën 11:50.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Ismajl Kurteshi